REPUBLIKA E SHQIPERISE

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

Bordi i Komisionereve

***VENDIM***
***Nr.47 Datë 21.06.2010***

**PËR**
**FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË LICENSIMIT TË SHOQËRISË "HYDROENERGY" SH.P.K NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "a", 9 dhe 13 pikat 1, gërma "d", të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*", të ndryshuar, nenit 10, pikat 1, dhe 3 të "Rregullores për proçedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licensave ", të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, dhe nenit 18, pikat 1, gërma "a", dhe 3, të "Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s", miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerve, Nr.21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 21.06.2010, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "HydroEnergy" sh.p.k për licensim në aktivitetin e Tregëtimit të Energjise Elektrike,

**Konstatoi se :**

Aplikimi i shoqërisë "HydroEnergy" sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germa a, b dhe c) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërma a,b,c,d,f dhe g) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni finaciar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa a, b dhe d) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) eshte paraqitur dhe plotesuar ne menyre korrekte.

# REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për licensë të shoqërisë "HydroEnergy" sh.p.k në aktivitetin e Tregëtimit të Energisë Elektrike.

2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve te ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**
**BUJAR NEPRAVISHTA**

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta"10 Tel/Fax +355 42 22 963
Tirane Tel +355 42 69 590
E-mail erealb@ere.gov.al www.ere.gov.al

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta"10 Tel/Fax +355 42 22 963
Tirane Tel +355 42 69 590
E-mail erealb@ere.gov.al www.ere.gov.al